



# **GJENDJA FINANCIARE DHE HUAMARRJA E NDËRMARRJEVE NË SHQIPËRI**

**Gjashtëmuji i parë 2020**

**BANKA E SHQIPËRISË  
DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR**

**Gusht 2020<sup>1</sup>**

---

<sup>1</sup> Për shkak të pandemisë së SARS-CoV-2, vërtimi është hedhur në terren gjatë muajit korrik 2020, duke përdorur forma të ndryshme për mbledhjen e informacionit të kërkuar, në respektim të masave parandaluese për të minimizuar përhapjen (intervista në distancim fizik, postë elektronike dhe telefon). Ky vërtim mbulon zhvillimet mbi gjendjen financiare dhe huamarrjen e ndërmarrjeve për gjashtëmuji i parë 2020, si edhe pritshmëritë për gjashtëmuji i dytë të vitit.

## PËRMBAJTJA

|   |    |
|---|----|
| Përmbledhje e gjetjeve kryesore të vrojtimit .....                | 2  |
| Gjendja financiare dhe huamarrja e ndërmarrjeve në Shqipëri ..... | 5  |
| 1- Organizimi dhe fusha e veprimit .....                          | 5  |
| 2- Ecuria financiare e ndërmarrjeve dhe prania e huasë .....      | 8  |
| 3- Karakteristikat e huamarrjes së ndërmarrjeve .....             | 14 |
| 4- Struktura e huasë.....   | 16 |
| 5- Ngarkesa e huasë .....   | 18 |
| 6- Marrëdhënia me bankat dhe pritshmëritë për të ardhmen.....     | 22 |

## Përmbledhje e gjetjeve kryesore të vrojtimit

Për këtë vrojtim u përdor një kampion prej 1,374 ndërmarrjesh të madhësive të ndryshme të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin dhe që kryejnë aktivitetin e tyre në sektorët kryesorë të ekonomisë. Nga këto, rreth 80% e totalit morën pjesë në vrojtim duke iu përgjigjur plotësisht ose pjesërisht pyetjeve të pyetësorit. Vlerësimet në vrojtim janë realizuar mbi bazën e numrit të ndërmarrjeve të përgjigjura dhe klasifikimit përkatës të tyre.

### • GJENDJA FINANCIARE

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2020, ndërmarrjet e vrojuara raportojnë se "*konkurrenca*" dhe "*gjetja e tregut*" vijojnë të mbeten sfidë për aktivitetin e tyre. **Gjithsesi, sfida kryesore paraqitet "*situata e krijuar nga pandemia*", e cila prek në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe problematikat e tjera me të cilat ndërmarrjet përballen.** Rëndësia e elementit të konkurrencës paraqitet në nivele thujtë të njëjta me periudhën e mëparshme, ndërkohë që gjetja e tregut vlerësohet në rritje për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve. Elemente të tjera të cilat kanë shfaqur rritje në vlerësim për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve gjatë kësaj periudhe, janë "*kosto e financimit*" dhe "*aksesi në financim*", veçanërisht për ndërmarrjet e vogla.

**Ecuria e nivelit të shitjeve dhe e rezultatit financiar paraqesin një rënie mjaft të theksuar për gjashtëmujorin e parë 2020 për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve, duke u vlerësuar më e dukshme për ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme.** Krahasimi me periudhat e mëparshme tregon përkeqësim të ndjeshëm. Të tre grupet e ndërmarrjeve shprehen për *ngushtim të veprimtarisë* së tyre, pa mundur të rrisin investimet për të zgjeruar aktivitetin e tyre. Pavarësisht ecurisë së përkeqësuar të këtyre treguesve, *pritshmëritë* e të gjitha ndërmarrjeve paraqiten pozitive lidhur me shitjet dhe rezultatit financiar për gjashtëmujorin e dytë 2020, madje më optimiste në krahasim me vrojtimin e mëparshëm. Lidhur me zgjerimin e veprimtarisë, ndërmarrjet shprehin gjithashtu *pritshmëri* pozitive, por ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha paraqiten më pak optimiste në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar.

Gjatë periudhës, rreth 40% e totalit të ndërmarrjeve të përgjigjura deklarojnë se e kanë financiar veprimtarinë e tyre nëpërmjet *shitjeve*. Mbështetja vetëm në këtë burim ka rënë ndjeshëm për të tre grupet e ndërmarrjeve. Ndërkohë, *prirja e kombinimit të burimeve të financimit* zë pjesën kryesore për periudhën dhe ka një peshë të konsiderueshme dhe të zgjeruar për të gjitha llojet e ndërmarrjeve. Për më shumë se gjysmën e ndërmarrjeve të të gjitha madhësive, financimi është realizuar nëpërmjet *kombinimit të shitjeve me rezervat e mbartura*.

### • HUAMARRJA

Rreth 40% e totalit të ndërmarrjeve të përgjigjura (437 ndërmarrje) deklarojnë se kanë aktualisht *hua për të paguar*. Kjo peshë ka shënuar një rritje me 2.6 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe 0.9 pp krahasuar me një vit më parë. Në terma të madhësisë së ndërmarrjeve, pesha e ndërmarrjeve huamarrëse ka rezultuar në rritje për grupin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mëdha krahasuar me periudhën e kaluar (përkatësisht me 8.3 pp dhe 3.7 pp), ndërkohë që kjo peshë ka shënuar një rënie prej 4.3 pp për ndërmarrjet e mesme.

Në total, *burimet formale të huamarrjes* (nga banka dhe institucione financiare jobanka) janë përdorur nga 91% e ndërmarrjeve huamarrëse të përgjigjura, në të njëjtin nivel me gjashtëmujorin e mëparshëm. Ndër to, rreth 89% e ndërmarrjeve huamarrëse deklarojnë se i janë drejtuar sektorit bankar si burim i vetëm huamarrjeje, 2.3 pp më e lartë krahasuar me gjysmën e dytë të vitit 2019. Kombinimi i burimeve *formale* dhe atyre *informale* është përdorur nga 3% e ndërmarrjeve.

Huamarrja e ndërmarrjeve përdoret kryesisht për të përballuar shpenzimet korrente (rreth 52% e totalit të ndërmarrjeve të përgjigjura) dhe për kryerjen e investimeve afatgjata (rreth 40% e ndërmarrjeve të përgjigjura). **Krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës, pesha e ndërmarrjeve të cilat kanë marrë hua për kryerjen e një investimi ka pësuar rënie për ndërmarrjet e mëdha, ndërkohë që huamarrja me qëllim përballimin e shpenzimeve korrente ka shënuar një rritje të ndjeshme për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve, duke reflektuar kështu situatën e krijuar nga pandemia e SARS-CoV-2.** Rreth 74% e ndërmarrjeve huamarrëse të vogla, rreth 75% e ndërmarrjeve të mesme dhe 84% e atyre të mëdha, e konsiderojnë të *përshtatshëm* nivelin e tyre të huamarrjes për financimin e veprimtarisë. Krahasuar me periudhën e kaluar, kjo peshë është më e lartë për ndërmarrjet e vogla dhe ato të mëdha, ndërkohë që është ulur për ndërmarrjet e mesme.

Huamarrja e ndërmarrjeve kryhet vetëm në *monedhën vendase* për 62% të ndërmarrjeve të vogla, 54% të ndërmarrjeve të mesme dhe 45% të ndërmarrjeve të mëdha, ndërsa pjesa tjetër është në valutë dhe/ose e kombinuar. Huamarrja *në valutë*, kryesisht në euro, rezulton më e përdorur nga ndërmarrjet e mëdha (43% e tyre) dhe më pak tek ndërmarrjet e vogla (32% e tyre).

Vlera totale e huasë rezulton *afërsisht sa gjysma e vlerës së kapitalit të ndërmarrjes* për rreth 80% të totalit të ndërmarrjeve huamarrëse dhe *e barabartë ose më e madhe se vlera e kapitalit* për afërsisht 20% të tyre. Të analizuar sipas madhësisë, raporti hua/kapital ka rezultuar më i lartë te ndërmarrjet e mëdha, ku 22% e tyre shprehen se ky raport është i barabartë ose tejkalon vlerën e kapitalit, duke nënkuptuar një ngarkesë më të lartë me borxh të tyre. Sidoqoftë, ky raport ka vijuar rënien për të tre grupet e ndërmarrjeve edhe për këtë gjashtëmujor. Në nivel sektorial, ngarkesa me borxh rezulton më e theksuar tek ndërmarrjet e sektorit të shërbimeve dhe ato të tregtisë.

#### • MARRËDHËNIA ME BANKAT

*Vështirësia e procesit të huamarrjes nga bankat* vlerësohet midis nivelit "normal" dhe "i vështirë", por në rritje krahasuar me periudhën e kaluar. *Marrëdhënia me bankat* vijon të vlerësohet midis nivelit "e rëndësishme" dhe "e domosdoshme", duke shënuar rritje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

**Lidhur me elementet që vështirësojnë përfitimin e një kredie bankare, kostoja e lartë e kredisë vijon të cilësohet si elementi kryesor veçanërisht në rastin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Sidoqoftë, vlerësimi për këtë element ka rezultuar në rënie krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar.**

Lidhur me planifikimin e një huamarrjeje në të ardhmen, rreth 39% e ndërmarrjeve të përgjigjura deklarojnë se "*nuk ka asnjë mundësi*" që të kërkojnë një kredi bankare gjatë periudhës së ardhshme, por në krahasim me vrojtimin e periudhës së mëparshme, kjo peshë ka rënë për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve. Paralelisht, vihet re një rritje e peshës së ndërmarrjeve që pohojnë se "ka pak mundësi" të marrin një kredi në gjysmën e dytë të vitit 2020, si edhe e peshës së ndërmarrjeve të cilat shprehen se "ka shumë mundësi" që diçka e tillë të ndodhë në periudhën pasardhëse. Nga ana tjetër, të gjitha grupet

e ndërmarrjeve, kanë shënuar një rënie për alternativën "është e sigurt", duke shprehur pasigurinë e situatës në planifikimin e huamarrjes.

## Gjendja financiare dhe huamarrja e ndërmarrjeve në Shqipëri

**Karakteristikat e kampionit të vrojtuar.** Vrojtimi i gjendjes financiare dhe huamarrjes së ndërmarrjeve kryhet që prej gjashtëmujorit të dytë 2010, me një frekuencë gjashtëmujore. Fillimisht, ky vrojtım u hodh në terren me një kampion të përzgjedhur prej 700 ndërmarrjesh me shitje neto vjetore më të lartë (ndërmarrje të mëdha). Më tej, në vitin 2016, kampioni u zgjerua në rreth 1200 ndërmarrje të mëdha, të mesme e të vogla, të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin. Në gjashtëmujorin e parë 2020, vrojtimi u realizua mbi një kampion total prej 1374 ndërmarrjesh, të shpërndara në 12 qarqet e vendit. Pjesa kryesore e këtyre ndërmarrjeve (rreth 78%) janë përqendruar në 4 qarqe, përkatësisht në: Tiranë (rreth 53%), Durrës (rreth 15%), Fier (rreth 6%) dhe Shkodër (rreth 4%).


Në totalin e kampionit të përzgjedhur, rreth 80% e ndërmarrjeve (gjithsej 1105 ndërmarrje) i janë përgjigjur pyetjeve të vrojtimit dhe analiza e rezultateve mbështetet në këto përgjigje. Në kushtet e një kampioni të zgjeruar, analiza e mëposhtme është organizuar kryesisht bazuar në ndarjen sipas madhësisë së ndërmarrjeve.

### 1. Organizimi dhe fusha e veprimit

#### 1.1 Shpërndarja sektoriale dhe madhësia e ndërmarrjeve


Për gjashtëmujorin e parë 2020, në ndarjen sipas sektorëve, rreth 37% e ndërmarrjeve i përkasin sektorit të industrisë, rreth 29% sektorit të shërbimeve, rreth 15% sektorit të ndërtimit dhe rreth 19% sektorit të tregtisë. Sipas madhësisë, rreth 24% e ndërmarrjeve klasifikohen si ndërmarrje të vogla (5-19 persona të punësuar), rreth 20% si ndërmarrje të mesme (20-49 të punësuar), dhe rreth 56% si ndërmarrje të mëdha (mbi 50 të punësuar). Në grupin e ndërmarrjeve të vogla, peshën kryesore e zënë ndërmarrjet që operojnë në sektorin e shërbimeve (rreth 44%), ndjekur nga sektori i tregtisë (rreth 24%). Nga ana tjetër, në grupin e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha, peshën më të lartë e kanë ndërmarrjet e sektorit të industrisë (përkatësisht prej rreth 41% dhe 42%) dhe ato të sektorit të shërbimeve (respektivisht 23% dhe 26%).

**Grafik 1.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Grafik 1.2 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe sektorëve të ekonomisë**




## 1.2 Sigurimi i lëndës së parë dhe shitja e produkteve


Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe të mëdha (respektivisht rreth 60%, 44% dhe 41% e tyre) sigurojnë *mbi 80% të lëndës së parë brenda vendit*. Krahasuar me periudhën paraardhëse (gjashtëmujorin e dytë 2019), ky tregues ka rënë me 1.9 pikë përqindje (pp) në rastin e ndërmarrjeve të vogla, 0.7 pp në rastin e ndërmarrjeve të mesme dhe me 1.5 pp tek ndërmarrjet e mëdha. Nga ana tjetër, rreth 36% e ndërmarrjeve të mëdha sigurojnë *deri në 20% të lëndës së parë brenda vendit*.

Shitja e produkteve vijon të mbetet *kryesisht brenda vendit*, ku rreth 82% e ndërmarrjeve të vogla, 66% e ndërmarrjeve të mesme dhe 56% e ndërmarrjeve të mëdha, kanë deklaruar se kanë shitur shumicën e produkteve në tregun vendas (mbi 80% të produkteve). Krahasuar me gjashtëmujorin e mëparshëm, ka vijuar të ketë një rritje të peshës së ndërmarrjeve të vogla e të mesme që i shesin produktet e tyre kryesisht brenda vendit (përkatësisht me 2.8 dhe 1.4 pp), ndërkohë që pesha e ndërmarrjeve të mëdha që deklarojnë një gjë të tillë, ka shënuar një rënie të lehtë (me 0.8 pp).

**Grafik 1.3 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas peshës së blerjes së lëndës së parë brenda vendit**



**Grafik 1.4 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas peshës së shitjeve brenda vendit**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Duke i analizuar përgjigjet sipas sektorëve, rezulton se sektori i ndërtimit ka një varësi më të madhe ndaj lëndës së parë të siguruar në vend, ku rreth 76% e ndërmarrjeve të këtij sektori siguron *mbi 80% të lëndës së parë brenda vendit*. Kjo peshë është ulur me 1.1 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 2 pp krahasuar me një vit më parë (gjashtëmujori i dytë 2018). Nga ana tjetër, sektori i industrisë shfaq varësi më të ulët, ku 48% e ndërmarrjeve të këtij sektori sigurojnë *vetëm 20% të lëndës së parë brenda vendit*. Gjithsesi, pesha e këtyre ndërmarrjeve ka vijuar të bjerë. Për periudhën në analizë, shënohet një rënie gjashtëmujore prej 1 pp, ndërsa në terma vjetorë kjo rënie është 4.6 pp.

**Tabelë 1.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas sektorëve dhe përqindjes së blerjes së lëndës së parë brenda vendit**

|          |            | Deri në 20% | 20-50% | 50-80% | Mbi 80% |
|----------|------------|-------------|--------|--------|---------|
| Industri | 6MII 2018  | 56,0%       | 4,8%   | 12,3%  | 26,9%   |
|          | 6MI 2019   | 52,5%       | 10,5%  | 11,0%  | 26,0%   |
|          | 6M II 2019 | 48,9%       | 8,6%   | 14,7%  | 27,8%   |
|          | 6MI 2020   | 47,9%       | 13,4%  | 13,4%  | 25,3%   |
| Shërbime | 6MII 2018  | 27,3%       | 4,9%   | 8,4%   | 59,3%   |
|          | 6MI 2019   | 18,6%       | 7,8%   | 11,9%  | 61,6%   |
|          | 6M II 2019 | 18,2%       | 5,7%   | 13,1%  | 63,0%   |
|          | 6MI 2020   | 16,7%       | 5,6%   | 12,0%  | 65,7%   |
| Ndërtim  | 6MII 2018  | 2,8%        | 3,3%   | 19,3%  | 74,6%   |
|          | 6MI 2019   | 3,2%        | 2,6%   | 18,7%  | 75,5%   |
|          | 6M II 2019 | 1,3%        | 3,2%   | 19,0%  | 76,6%   |
|          | 6MI 2020   | 3,7%        | 2,5%   | 18,4%  | 75,5%   |
| Tregti   | 6MII 2018  | 46,7%       | 13,2%  | 13,7%  | 26,4%   |
|          | 6MI 2019   | 33,5%       | 14,2%  | 15,2%  | 37,1%   |
|          | 6M II 2019 | 30,6%       | 14,5%  | 19,2%  | 35,8%   |
|          | 6MI 2020   | 32,7%       | 19,5%  | 14,6%  | 33,2%   |

Burimi: Banka e Shqipërisë.

### 1.3 Elementet kufizuese në aktivitetin e ndërmarrjeve<sup>2</sup>


Gjatë periudhës, ndërmarrjet e vrojtura raportojnë se "konkurrenca" dhe "gjetja e tregut" vijnë të mbeten sfidë për aktivitetin e tyre. Gjithsesi, sfida kryesore paraqitet "situata e krijuar nga pandemia", e cila prek në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe problematikat e tjera me të cilat ndërmarrjet përballen<sup>3</sup>. Rëndësia e elementit të konkurrencës paraqitet në nivele thuajse të njëjta me periudhën e mëparshme, ndërkohë që gjetja e tregut vlerësohet në rritje për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve. Elemente të tjera të cilat kanë shfaqur rritje në vlerësim për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve gjatë kësaj periudhe, janë "kosto e financimit" dhe "aksesi në financim", veçanërisht për ndërmarrjet e vogla.

<sup>2</sup> Ndërmarrjet kanë vlerësuar rëndësinë e disa problemeve të caktuara sipas një shkalle nga 1 deri në 10, ku 1 është shkalla më e ulët dhe 10 është shkalla më e lartë e vështirësisë. Për të agreguar përgjigjet për secilën çështje të vlerësuar, është llogaritur një mesatare e peshuar për të gjitha ndërmarrjet e përgjigjura, duke peshuar përgjigjet e tyre me shkallët e vlerësimit (1-10).

<sup>3</sup> Kjo problematikë është specifikuar në alternativën "Të tjera" dhe është zgjedhur nga 37% e kampionit të ndërmarrjeve që janë përgjigjur.



**Grafik 1.5. Vlerësimi i ndikimit të disa faktorëve në veprimtarinë e ndërmarrjes**



Burimi: Banka e Shqipërisë.


## 2. Ecuria financiare e ndërmarrjeve dhe prania e huasë

### 2.1 Monedha e kryerjes së veprimtarisë

Euroizimi i veprimtarisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme vijon të mbetet i ulët gjatë periudhës. Kështu, rreth 77% e ndërmarrjeve të vogla dhe 62% e atyre të mesme deklarojnë se e kryejnë veprimtarinë *plotësisht* ose *kryesisht*<sup>4</sup> në monedhën vendase. Përdorimi i valutës vijon të mbetet më i theksuar tek ndërmarrjet e mëdha, ku 38% e tyre deklarojnë se e kryejnë veprimtarinë *kryesisht* ose *plotësisht* në valutë. Kjo peshë është rritur me 4 pp për periudhën.

<sup>4</sup> Mbi 50% të veprimtarisë në lekë.

**Grafik 2.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe monedhës së kryerjes së veprimtarisë**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 2.2 Ecuria e shitjeve, rezultati financiar dhe zgjerimi i veprimtarisë

Gjatë gjashtëmujorit të parë 2020, ndërmarrjet e vogla raportojnë një rënie të theksuar të nivelit të shitjeve me një balancë neto negative prej [72.2%], me një përkeqësim të ndjeshëm në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë, ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjendja e krijuar nga pandemia e SARS-CoV-2. Situata ka rezultuar e ngjashme edhe për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, të cilat kanë shënuar balanca neto negative të shitjeve, respektivisht me [76.6%] dhe [64.5%], duke shfaqur gjithashtu përkeqësim krahasuar me të gjitha periudhat paraardhëse. Për sa i përket pritshmërive për nivelin e shitjeve të përgjithshme në gjashtëmujorin e ardhshëm, ndonëse ecuria e shitjeve paraqet një situatë të rënduar, të tre grupet e ndërmarrjeve vijojnë të kenë pritshmëri pozitive lidhur me ecurinë e tyre. Për gjashtëmujorin e dytë të vitit, pritet një rritje e nivelit të shitjeve, madje ndërmarrjet paraqiten më optimiste në krahasim me periudhat e mëparshme.


**Grafik 2.2 Balanca neto e shitjeve**



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Balancat neto të përgjigjeve janë llogaritur si diferencë midis peshave të përgjigjeve pozitive (rritje e shitjeve/rritje e pritshmërive të shitjeve) dhe përgjigjeve negative (rënie e shitjeve/rënie e pritshmërive mbi shitjet) ndaj totalit të përgjigjeve të dhëna.

**Grafik 2.3 Balanca neto e pritshmërive të shitjeve**




Rezultatet paraqiten të ngjashme edhe për *ndryshimin e rezultatit financiar* për gjysmën e parë të vitit 2020, duke ndjekur ecurinë e balancës së shitjeve të përgjithshme. Kështu, ndërmarrjet e vogla vlerësojnë rënie të theksuar të rezultatit financiar gjatë periudhës, me një balancë neto negative prej [70%], mjaft e zgjeruar në krahasim me periudhat paraardhëse. Edhe ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha deklarojnë balanca negative të rezultatit financiar, respektivisht [71.1%] dhe [61.9%], në përqendrim të ndjeshëm krahasuar me periudhat e mëparshme. *Pritshmëritë për gjashtëmuajin e ardhshëm* janë pozitive për të tre grupet e ndërmarrjeve dhe më optimiste se në gjashtëmuajin paraardhës, çka shkon në të njëjtën linjë me pritshmëritë për ecurinë e shitjeve.

**Grafik 2.4 Balanca neto e rezultatit financiar**



**Grafik 2.5 Balanca neto e rezultatit financiar të pritshëm në gjashtëmuajin e ardhshëm**




*Burimi: Banka e Shqipërisë.*


*Balancat neto të përgjigjeve janë llogaritur si diferencë midis peshave të përgjigjeve pozitive (rritje e rezultatit financiar/rritje e pritshmërive) dhe përgjigjeve negative (rënie e rezultatit financiar/rënie e pritshmërive) ndaj totalit të përgjigjeve të dhëna.*

Për sa i takon *zgjërimit të veprimtarisë* apo rritjes së investimeve për gjysmën e parë të vitit 2020, të tre grupet e ndërmarrjeve kanë shënuar balanca neto negative, përkatësisht [1.7%] në rastin e ndërmarrjeve të vogla, [2.3%] për ndërmarrjet të mesme dhe [9.2%] për ato të mëdha. Situata e krijuar nga pandemia ka ndikuar dukshëm në vendimmarrjen lidhur investimet apo zgjerimin e aktivitetit të ndërmarrjeve, duke e bërë të pamundur këtë aspekt për periudhën. *Për gjashtëmuajin e ardhshëm* (6MII 2020), balancat neto të përgjigjeve kanë rezultuar pozitive për të tre grupet e ndërmarrjeve, çka nënkupton pritshmëri për investim apo zgjerim të mëtejshëm të veprimtarisë, por në krahasim me periudhat paraardhëse të vrojtuar, këto pritshmëri janë më pak optimiste për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha.

**Grafik 2.6 Balanca neto e zgjerimit të veprimtarisë**



**Grafik 2.7 Balanca neto e zgjerimit të veprimtarisë në gjashtëmujorin e ardhshëm**




Burimi: Banka e Shqipërisë. Balancat neto të përgjigjeve janë llogaritur si diferencë midis peshave të përgjigjeve pozitive (zgjerim i veprimtarisë/ pritshmëri për zgjerim apo investim) dhe përgjigjeve negative (ngushtim i veprimtarisë/pritshmëri për ngushtim) ndaj totalit të përgjigjeve të dhëna.

### 2.3 Niveli i shitjeve dhe rezultati financiar


Ecuria e agreguar e nivelit të shitjeve të përgjithshme është analizuar nëpërmjet një indeksi<sup>5</sup>, i cili peshon përgjigjet e ndërmarrjeve sipas intervaleve të ndryshme dhe i grupon ato sipas madhësisë së ndërmarrjeve dhe sipas sektorëve.

Në ndarjen sipas madhësisë, ecuria e vlerave të indeksit tregon një rënie të shitjeve të përgjithshme për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve, më e ndjeshme për ndërmarrjet e mesme. Rezultatet e indeksit sipas sektorëve tregojnë gjithashtu një rënie të shitjeve të përgjithshme për të gjithë sektorët e ekonomisë. Krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, rënia më e theksuar i përket sektorit të ndërtimit. Sipas këtij indeksi, vlerat më të larta të shitjeve janë realizuar nga sektori i tregtisë, ndërkohë që vlerat më të ulëta i përkasin sektorit të shërbimeve.

**Grafik 2.8 Indeksi i përgjithshëm i shitjeve sipas madhësisë së ndërmarrjeve**



**Grafik 2.9 Indeksi i shitjeve të përgjithshme sipas sektorëve**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

<sup>5</sup> Koefficientët e peshimit sipas intervaleve të shitjeve të përgjithshme janë: "Deri në 10 milionë lekë" = 0; "10-49 milionë lekë" = 0.25; "50-99 milionë lekë" = 0.5; "100-500 milionë lekë" = 0.75; "Mbi 500 milionë lekë" = 1. Rritja/ulja e vlerës së këtij indeksi nënkupton një rritje/ulje të nivelit të shitjeve të përgjithshme të ndërmarrjeve.

Lidhur me *rezultatit financiar* për gjashtëmujorin e parë 2020, vetëm 968 ndërmarrje kanë dhënë informacion (ose rreth 70% e totalit të kampionit). Në grupin e ndërmarrjeve të përgjigjura, mbi 75% e secilit grup sipas madhësisë kanë raportuar *fitim* gjatë periudhës. Kjo peshë ka rezultuar më e lartë për ndërmarrjet e mëdha (rreth 84%) dhe më e ulët tek ato të vogla (rreth 75.4%). Krahasuar me periudhën e mëparshme, peshë e ndërmarrjeve që kanë raportuar fitim ka shënuar rënie për të tre grupet e ndërmarrjeve.


**Grafik 2.10 Rezultati financiar sipas madhësisë së ndërmarrjeve**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Për ndërmarrjet të cilat raportojnë fitim*, të gjitha grupet e ndërmarrjeve pohojnë një rënie të theksuar të nivelit të shitjeve dhe të rezultatit financiar. Zgjerimi i veprimtarisë paraqitet me balanca negative për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, ndërkohë që ka një balancë pozitive prej 2.2% për ndërmarrjet e vogla që raportojnë fitim, ndonëse pjesa më e madhe e tyre raportojnë mosndryshim të këtij aspekti për periudhën. Balancat neto të të gjitha ndërmarrjeve paraqiten të përkeqësuar lidhur me shitjet, rezultatit financiar dhe zgjerimin e veprimtarisë në krahasim me fundin e vitit 2019. Për sa i përket pritshmërive për gjashtëmujorin e ardhshëm, ndërmarrjet vijojnë të mbeten pozitive dhe më optimiste mbi ecurinë e shitjeve dhe të rezultatit financiar krahasuar me periudhën e mëparshme. Balancat janë pozitive edhe mbi pritshmëritë lidhur me zgjerimin e veprimtarisë, po ndërmarrjet e mesme e të mëdha paraqiten më pak optimiste në krahasim me periudhën paraardhëse.

**Grafik 2.11 Balancat neto për ndërmarrjet me fitim**




**Grafik 2.12 Balancat neto për pritshmëritë e ndërmarrjeve me fitim**



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Për ndërmarrjet të cilat raportojnë humbje, të tre grupet e ndërmarrjeve raportojnë balanca negative për nivelin e shitjeve, rezultatin financiar dhe zgjerimin e veprimtarisë apo rritjen e investimeve gjatë periudhës. Këto balanca janë thelluar ndjeshëm lidhur me shitjet dhe rezultatin financiar. Pritshmëritë e ndërmarrjeve me humbje janë pozitive për gjashtëmujorin pasues lidhur me nivelin e ardhshëm të shitjeve, rezultatin financiar dhe me zgjerimin e veprimtarisë për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve. Këto pritshmëri janë më optimiste në lidhje me zgjerimin e veprimtarisë për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve, si edhe lidhur me rezultatin financiar të ardhshëm për ndërmarrjet e mëdha.

**Grafik 2.13 Balancat neto të ndërmarrjeve me humbje**



Burimi: Banka e Shqipërisë.


**Grafik 2.14 Balancat neto të pritshmërive të ndërmarrjeve me humbje**



## 2.4 Financimi i veprimtarisë

Gjatë periudhës, vetëm rreth 40% e ndërmarrjeve kanë vijuar të financojnë veprimtarinë e tyre kryesisht nëpërmjet *shitjeve* (39% e ndërmarrjeve të vogla dhe 41% e ndërmarrjeve të mesme e të mëdha). Krahasuar me gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019, mbështetja vetëm tek shitjet është ngushtuar ndjeshëm për të tre grupet e ndërmarrjeve. Ndërkohë, prirja e kombinimit të burimeve të financimit zë pjesën kryesore për periudhën dhe ka një peshë të konsiderueshme dhe të zgjeruar për të gjitha llojet e ndërmarrjeve. Për më shumë se gjysmën e ndërmarrjeve të të gjitha madhësive, financimi është realizuar nëpërmjet kombinimit të shitjeve me rezervat e mbartura.

**Grafik 2.15 Financimi i veprimtarisë sipas madhësisë së ndërmarrjeve**



### 3. Karakteristikat e huamarrjes së ndërmarrjeve

Rreth 40% e totalit të ndërmarrjeve që janë përgjigjur<sup>6</sup> (gjithsej 437 ndërmarrje) pohojnë që kanë një hua për të paguar. Kjo peshë ka shënuar një rritje me 2.6 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe 0.9 pp krahasuar me një vit më parë. Në terma të madhësisë së ndërmarrjeve, pesha e ndërmarrjeve huamarrëse ka rezultuar në rritje për grupin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mëdha krahasuar me periudhën e kaluar (përkatësisht me 8.3 pp dhe 3.7 pp), ndërkohë që kjo peshë ka shënuar një rënie prej 4.3 pp në rastin e ndërmarrjeve të mesme. Në ndarjen sipas sektorëve, pesha më e lartë e ndërmarrjeve huamarrëse rezulton në sektorin e tregtisë (rreth 53%), ndjekur nga sektori i industrisë (41%). Pesha e ndërmarrjeve huamarrëse në të dy këta sektorë ka qenë e pandryshuar për tregtinë, ndërkohë që sektori i industrisë ka ardhur në rritje në krahasim me periudhën e kaluar.

**Tabelë 3.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe huamarrjes**

| Ndërmarrjet huamarrëse sipas madhësisë | Nr. i ndërmarrjeve |            | Pesha ndaj totalit të grupit |              |
|--|--------------------|------------|------------------------------|--------------|
|  | 6MII 2019          | 6MI 2020   | 6MII 2019                    | 6MI 2020     |
| Të vogla                               | 53                 | 82         | 22,8%                        | 31,2%        |
| Të mesme                               | 74                 | 77         | 39,6%                        | 35,3%        |
| Të mëdha                               | 283                | 278        | 41,0%                        | 44,6%        |
| <b>Total ndërmarrje</b>                | <b>410</b>         | <b>437</b> | <b>37,0%</b>                 | <b>39,6%</b> |

Burimi: Banka e Shqipërisë.


Analiza e mëposhtme është realizuar duke u mbështetur vetëm në përgjigjet e ndërmarrjeve huamarrëse.

#### 3.1 Burimi i huasë

Rreth 89% e ndërmarrjeve huamarrëse deklarojnë se i janë drejtuar sektorit bankar si burim huamarrje, ndërsa mbi 5% e tyre e kanë kombinuar edhe me burime të tjera. Pesha e ndërmarrjeve huamarrëse nga bankat është rritur me 2.3 pp krahasuar me gjysmën e dytë të vitit 2019. Të ndara sipas madhësisë, rezulton se rreth 81% e ndërmarrjeve të vogla, 94% e atyre të mesme dhe 89% e ndërmarrjeve të mëdha i janë drejtuar vetëm bankave si burim huamarrje. Këto pesha kanë shënuar rritje për ndërmarrjet e mesme e të mëdha në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Përveç bankave, një pjesë e ndërmarrjeve i janë drejtuar edhe institucioneve financiare jobanka ose kanë kombinuar disa burime formale dhe informale (si hua nga persona fizikë, kompani të tjera, mall i papaguar).

<sup>6</sup> Duke marrë në konsideratë kampionin e plotë prej 1374 ndërmarrjesh, vetëm 1105 prej tyre ose rreth 80% kanë dhënë përgjigje.

**Grafik 3.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas burimit të huasë**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në total, *burimet formale të huamarrjes* (nga banka dhe institucione financiare jobanka) janë përdorur nga 91% e ndërmarrjeve huamarrëse të përgjigjura (rreth 86% e ndërmarrjeve të vogla, 96% e ndërmarrjeve të mesme dhe 92% e atyre të mëdha), në të njëjtin nivel me gjashtëmujorin e mëparshëm. Kombinimi i burimeve formale dhe atyre informale është përdorur nga 3% e ndërmarrjeve.

### 3.2 Qëllimi i huasë

Huamarrja e ndërmarrjeve përdoret kryesisht për të përballuar shpenzimet korrente (rreth 52% e totalit të ndërmarrjeve të përgjigjura) dhe për kryerjen e investimeve afatgjata (rreth 40% e ndërmarrjeve të përgjigjura). Krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës, pesha e ndërmarrjeve që kanë marrë hua për kryerjen e një investimi ka pësuar rënie për ndërmarrjet e mëdha, ndërkohë që huamarrja me qëllim përballimin e shpenzimeve korrente ka shënuar një rritje të ndjeshme për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve, duke reflektuar kështu situatën e krijuar nga pandemia e SARS-CoV-2.

**Grafik 3.2 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas qëllimit të përdorimit të huasë**




Burimi: Banka e Shqipërisë.



### 3.3 Mjaftueshmëria e huasë

Gjatë periudhës, rreth 74% e ndërmarrjeve huamarrëse të vogla, 75% e ndërmarrjeve të mesme dhe 84% e atyre të mëdha, e konsiderojnë të përshtatshëm nivelin e tyre të huamarrjes për financimin e veprimtarisë së tyre. Krahasuar me periudhën e kaluar, kjo peshë është rritur për ndërmarrjet e vogla dhe për ato të mëdha, ndërkohë që është ulur për ato të mesme. Pjesa tjetër e përgjigjeve ka rezultuar në balanca neto pozitive dhe në rritje për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve. Kjo balancë tregon se pesha e ndërmarrjeve që do të preferonin më shumë hua është më e lartë se pesha e atyre që do të preferonin më pak hua për financimin e veprimtarisë. Duke e krahasuar këtë rezultat me atë të vrojtimit të kaluar, kërkesa për hua paraqitet e zgjeruar në këtë periudhë.

**Grafik 3.3 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas mjaftueshmërisë së huasë**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 4. Struktura e huasë

### 4.1 Monedha

Për sa i përket monedhës së huamarrjes së ndërmarrjeve, gjatë periudhës, 61% e ndërmarrjeve të vogla, 54% e ndërmarrjeve të mesme dhe 45% e ndërmarrjeve të mëdha, deklarojnë se huaja e tyre është vetëm në monedhën vendase, ndërsa pjesa tjetër është në valutë (euro dhe/ose dollarë) dhe/ose e kombinuar (lekë dhe valutë). Gjatë periudhës, huamarrja në valutë (kryesisht në euro) rezulton më e përdorur nga ndërmarrjet e mëdha (43% e tyre) dhe më pak nga ndërmarrjet e vogla (32% e tyre). Ky element ndikohet edhe nga monedha në të cilën këto ndërmarrje kryejnë veprimtarinë e tyre. Sidoqoftë, krahasuar me një gjashtëmujor më parë, pesha e ndërmarrjeve me hua në monedhë të huaj ka rezultuar në rënie për grupin e ndërmarrjeve të mëdha (prej 11 pp) dhe ndërmarrjeve të vogla (prej 3 pp), ndërkohë që ka shënuar rritje (prej 3 pp) për ndërmarrjet e mesme.

**Grafik 4.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas monedhës së huasë**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

#### 4.2 Marrja e huasë dhe afati i maturimit

Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve kanë marrë hua në *1-5 vitet e fundit*, përkatësisht rreth 44% e ndërmarrjeve të vogla, 47% e ndërmarrjeve të mesme dhe 42% e ndërmarrjeve të mëdha. Kjo peshë ka ardhur në rënie krahasuar me një gjashtëmujor më parë për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve (përkatësisht me 3.3 pp për ndërmarrjet e vogla, 13 pp për ato të mesme dhe 2.8 pp për ndërmarrjet e mëdha).

*Huamarrja e re*, e cila nënkupton huamarrjen në *gjashtëmujorin e fundit*, deklarohet nga rreth 18% e ndërmarrjeve të vogla, 13% e ndërmarrjeve të mesme dhe 19% e ndërmarrjeve të mëdha. Në terma gjashtëmujorë, pesha e huamarrësve të rinj ka rezultuar në rritje për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve; ndërsa në terma vjetorë, rritje kanë shënuar vetëm ndërmarrjet e vogla. *Qëllimi kryesor i përdorimit të huamarrjes së re* ka qenë *përballimi i shpenzimeve korrente* (për 75% të totalit të ndërmarrjeve) dhe *kryerja e një investimi afatgjatë* (18% të totalit të ndërmarrjeve). Krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, pesha e ndërmarrjeve që kanë marrë hua të re për të përballuar shpenzimet korrente është rritur ndjeshëm, ndërkohë që pesha e atyre që kanë marrë hua të re për të kryer një investim afatgjatë rezulton në rënie. Kjo prirje vihet re për të tre grupet e ndërmarrjeve, në reflektim të gjendjes së pandemisë. Afati mesatar i mbetur i huamarrjes ka rezultuar 63.1 muaj për ndërmarrjet e vogla, 65.8 muaj për ndërmarrjet e mesme dhe 60.1 muaj për ato të mëdha.

#### 4.3 Norma e interesit të huasë dhe mënyra e shlyerjes

Lloji kryesor i normës së interesit të huasë më të madhe ekzistuese<sup>7</sup>, mbetet *norma e pandryshueshme deri në fund të afatit* (për 81% të ndërmarrjeve të vogla, 77% e atyre të mesme dhe 79% e ndërmarrjeve të mëdha) dhe *norma e ndryshueshme çdo vit* (për 13% të ndërmarrjeve të vogla, 7% të ndërmarrjeve të mesme dhe 16% të ndërmarrjeve të mëdha). Gjatë periudhës, pesha e ndërmarrjeve që raportojnë hua me normë të pandryshueshme ka rezultuar në rritje krahasuar me periudhën paraardhëse, në rastin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe në rënie për ndërmarrjet e mëdha. Frekuenca e shlyerjes vijon të mbetet kryesisht mujore, për 83% të ndërmarrjeve huamarrëse të vogla e të mëdha dhe për 82% të

<sup>7</sup> Në rastin e ndërmarrjeve, të cilat kanë më shumë se një hua.



ndërmarrjeve të mesme, ndonëse kjo peshë ka rënë për periudhën për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve.

#### 4.4 Forma e kolateralit dhe raporti i mbulimit

Rreth 82% e ndërmarrjeve të vogla, 83% e ndërmarrjeve të mesme dhe 64% e atyre të mëdha, deklarojnë se huaja e marrë është e kolateralizuar *vetëm me pasuri të paluajtshme*, ndërsa pjesa tjetër e ndërmarrjeve ka përdorur forma të tjera kolateralizimi<sup>8</sup>. Ndërkohë, rreth 27% e ndërmarrjeve të vogla, rreth 12% e ndërmarrjeve të mesme dhe 20% e ndërmarrjeve të mëdha, pohojnë se huaja e marrë është e pakolateralizuar. Krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, pesha e ndërmarrjeve me hua të pakolateralizuar ka shënuar rritje për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve, ndërkohë që ka një rritje të kolateralizimit me mjete financiare dhe dorëzani/garanci. Rezultatet e këtij gjashtëmujori lidhen dukshëm me huamarrjen e re për periudhën, e cila ka pasur si qëllim kryesor përballimin e shpenzimeve korrente.

*Mbulimi me kolateral* vlerësohet edhe në mënyrë të agreguar përmes indeksit të peshuar të përgjigjeve<sup>9</sup>. Për gjashtëmujorin e parë 2020, ky indeks ka rezultuar 0.57 për ndërmarrjet e vogla, 0.56 për ndërmarrjet e mesme dhe 0.62 për ato të mëdha. Krahasuar me periudhën e kaluar, raporti i mbulimit ka rezultuar në rënie për ndërmarrjet e vogla dhe ato të mëdha.

**Grafik 4.2 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas formës së kolateralit të huasë**      **Grafik 4.3 Indeksi i mbulimit me kolateral**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 5. Ngarkesa e huasë

### 5.1 Vlera e huasë ndaj kapitalit


Gjatë periudhës, vlera totale e huasë rezulton afërsisht sa *gjysma e vlerës së kapitalit të ndërmarrjes* për 80% të ndërmarrjeve huamarrëse dhe *e barabartë ose më e madhe se vlera e kapitalit* për 20% të tyre. Raporti hua/kapital ka rezultuar më i lartë te ndërmarrjet e mëdha, ku 22% e tyre shprehen se ky raport

<sup>8</sup> Mjete financiare, dorëzani, garanci të tjera, së bashku me kombinimin e disa formash kolateralizimi, përfshirë edhe kombinimin me pasuritë e paluajtshme.

<sup>9</sup> Ky indeks merr vlera nga 0 në 1 dhe rritja e vlerës së tij tregon rritje të peshës së mbulimit me kolateral. Koeficientët e peshimit të këtij indeksi, sipas alternativave, janë: "deri në 50% të vlerës së huasë së kolateralizuar" = 0.25; "50-100% të vlerës së huasë së kolateralizuar" = 0.5; "100-120% të vlerës së huasë së kolateralizuar" = 0.75; "mbi 120% të huasë së kolateralizuar" = 1.

është i barabartë ose tejkalon vlerën e kapitalit, duke nënkuptuar një ngarkesë më të lartë me borxh. Sidoqoftë, ky raport ka vijuar rënien për të tre grupet e ndërmarrjeve edhe për këtë gjashtëmuor.

**Grafik 5.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe raportit hua/kapital**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në nivel sektorial, ngarkesa me borxh rezultojn më e shprehur tek ndërmarrjet e sektorit të shërbimeve dhe ato të tregtisë.

**Tabelë 5.1 Pesha e ndërmarrjeve me një vlerë huaje të barabartë ose më të lartë se kapitali, sipas sektorëve**

| Pesha e ndërmarrjeve me një vlerë huaje të barabartë ose më të lartë se kapitali, sipas sektorëve |          |          |         |        |
|---|----------|----------|---------|--------|
|   | Industri | Shërbime | Ndërtim | Tregti |
| 6MII 2018   | 20,7%    | 14,9%    | 15,0%   | 29,6%  |
| 6MI 2019  | 26,8%    | 18,5%    | 18,3%   | 28,8%  |
| 6MII 2019   | 20,4%    | 28,0%    | 13,4%   | 26,5%  |
| 6MI 2020  | 16,4%    | 22,9%    | 19,7%   | 22,2%  |


Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 5.2 Shpenzimi për pagesën e huasë

Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve huamarrëse (76%) deklarojnë se pagesa e huasë arrin *deri në 20% të të ardhurave* të tyre. Pesha e këtyre ndërmarrjeve ka shfaqur rritje prej 9 pp krahasuar me vrojtimin paraardhës. Barra e pagesës së huasë duket se rëndon më tepër tek ndërmarrjet e vogla, ku pesha e ndërmarrjeve që raportojnë se kjo pagesë tejkalon 20% të të ardhurave, zë 29% të totalit të grupit<sup>10</sup>, ndërsa për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, kjo peshë shënon respektivisht 25% dhe 22%. Të pyetura nëse *kostoja e shërbimit të huasë ka ndryshuar* gjatë periudhës, pjesa më e madhe e ndërmarrjeve (rreth 85% e ndërmarrjeve të vogla, 82% e ndërmarrjeve të mesme dhe 93% e ndërmarrjeve të mëdha), pohojnë që ky shpenzim ka mbetur i pandryshuar. Përgjigjet e pjesës tjetër kanë rezultuar në balanca neto pozitive për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve, duke treguar rritje të këtij shpenzimi në raport me të ardhurat.


<sup>10</sup> Llogaritur si shumë e peshave të përgjigjeve: "20-50% të të ardhurave", "50-80% të të ardhurave" dhe "mbi 80% të të ardhurave".

**Grafik 5.2 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas raportit të pagesës së huasë ndaj të ardhurave**



Burimi: Banka e Shqipërisë.


**Grafik 5.3 Ndërmarrjet që deklarojnë ndryshim të pagesës së huasë gjatë periudhës**



### 5.3 Përballimi i koston së huasë

Në rastin e rritjes së koston së shërbimit të huasë, ndërmarrjet janë mbështetur kryesisht në uljen e shpenzimeve të tjera (41%). Gjithashtu, për një pjesë të konsiderueshme të ndërmarrjeve janë përdorur rezervat e ndryshme (32%), në linjë me përgjigjet e ndërmarrjeve edhe për mënyrën e financimit të veprimtarisë.

**Grafik 5.4 Mënyrat e përballimit të koston së huasë**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 5.4 Ngarkesa me borxh

Ngarkesa me borxh e ndërmarrjeve huamarrëse vlerësohet në rritje përgjatë periudhës, ku vlera e indeksit<sup>11</sup> për totalin e ndërmarrjeve ka rezultuar 0.62. Sipas madhësisë, indeksi paraqet një rritje të ngarkesës me borxh për ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme krahasuar me gjashtëmujorin e mëparshëm.

**Grafik 5.5 Indeksi i ngarkesës me borxh të ndërmarrjeve**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 5.5 Pritshmëritë për pagesën e kështit të huasë për gjashtëmujorin e ardhshëm

Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve huamarrëse, pavarësisht madhësisë së tyre (rreth 90%) nuk presin ndryshim të kështit të huasë në gjashtëmujorin e dytë 2020. Kjo peshë është rritur me 5 pp në krahasim me periudhën paraardhëse. Për sa i përket ndërmarrjeve që presin ndryshim të kështit, rezulton se ndërmarrjet e vogla dhe ato të mëdha presin rënie në këtë drejtim në gjashtëmujorin e ardhshëm, ndonëse ato janë më pak optimiste krahasuar me gjashtëmujorin e mëparshëm. Ndërkohë, ndërmarrjet e mesme paraqiten neutrale në përgjigjet e tyre.

**Grafik 5.6 Pritshmëritë mbi ndryshimin e kështit të huasë në gjashtëmujorin e ardhshëm**

<sup>11</sup> Indeksi llogaritet duke peshuar përgjigjet e ndërmarrjeve ndaj totalit të përgjigjeve, sipas koeficientëve që marrin vlerat: 1 për alternativën "ngarkesë e lartë", 0.5 për alternativën "ngarkesë mesatare" dhe vlerën 0 për alternativën "ngarkesë e ulët".




Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 6. Marrëdhënia me bankat dhe pritshmëritë për të ardhmen<sup>12</sup>

### 6.1 Aksesi në financim

Kërkesa e ndërmarrjeve për kredi paraqet rritje për periudhën, ku 14% e tyre deklarojnë se kanë aplikuar për financim gjatë gjashtëmujorit të fundit. Kjo peshë është zgjeruar me 3 pp në krahasim me vrojtimin e kaluar. Duke e analizuar këtë tregues sipas madhësisë së ndërmarrjeve, rezultojnë se peshën më të lartë për këtë periudhë e kanë ndërmarrjet e vogla (rreth 17%). Krahasuar me gjashtëmujorin e mëparshëm, vërehet një zgjerim i kërkesës për kredi nga ndërmarrjet e vogla (prej 9.1 pp) dhe ato të mesme (2.8 pp).

**Grafik 6.1 Kërkesa për financim e ndërmarrjeve**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndërmarrjet që nuk kanë aplikuar për hua, në shumicën e rasteve, pohojnë kryesisht se nuk e kanë të nevojshme për veprimtarinë që kryejnë. Kjo peshë rezultojnë më e lartë tek ndërmarrjet e mëdha, ndonëse në rënie për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve. Pjesa tjetër e ndërmarrjeve kanë vendosur të mos aplikojnë, për shkak se procesi u duket i vështirë apo për shkak se e vlerësojnë si më të thjeshtë huamarrjen nga burime alternative. Të dyja këto arsye vijojnë të pohohen më shpesh nga ndërmarrjet e përgjigjura.

<sup>12</sup> Pyetjet e kësaj rubrike i janë drejtuar të gjithë kampionit të ndërmarrjeve, përfshirë edhe ato johuamarrëse.


**Grafik 6.2 Ndërmarrjet që nuk kanë aplikuar për kredi sipas madhësisë**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Të pyetur se si do të vepronin nëse nuk do të financoheshin nga bankat, më shumë se gjysma e ndërmarrjeve të vogla (55%) pohojnë se do të merrnin hua nga burime alternative, me një peshë më të lartë në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Ndërkohë, kjo peshë është rritur edhe për ndërmarrjet e mesme (49%) dhe ato të mëdha (39%). Gjithashtu, një pjesë e konsiderueshme e ndërmarrjeve pohojnë se do t'i drejtohen sërish një banke apo institucioni tjetër. Pjesa tjetër e ndërmarrjeve pohojnë shtyrje në kohë të planeve të tyre për zgjerim të veprimtarisë në kushtet e mungesës së financimit. Kjo peshë ka ardhur në rënie për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha.

**Grafik 6.3 Mundësitë e financimit në rast mosfinancimi nga bankat**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 6.2 Procesi i huamarrjes dhe marrëdhënia me bankat

Indeksi i vështirësisë së procesit të huamarrjes nga bankat, për gjashtëmujorin e parë 2020 ka rezultuar 0.39 për totalin e ndërmarrjeve, duke shënuar rritje në krahasim me periudhën paraardhëse. Ky indeks vijon të mbetet midis nivelit "normal" dhe "i vështirë", për të tre grupet e ndërmarrjeve. Krahasuar me gjashtëmujorin e dytë 2019, niveli i vështirësisë vijon të mbetet më i lartë për ndërmarrjet e vogla, ndonëse ai paraqet rritje për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve.




**Grafik 6.4 Indeksi i vështirësisë së marrjes së një huaje nga bankat në vend**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Marrëdhënia me bankat, e matur nga indeksi përkatës, vijon të vlerësohet midis nivelit "e rëndësishme" dhe "e domosdoshme". Ecuria e këtij indeksi gjatë periudhës ka shënuar rritje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ndërkohë që ka rënë për ndërmarrjet e mëdha.

**Grafik 6.5 Indeksi i rëndësisë së marrëdhënies me bankat**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim: Indeksi llogaritet duke peshuar peshat e përgjigjeve të ndërmarrjeve ndaj totalit të përgjigjeve, sipas koeficientëve që marrin vlerat: 1 për alternativën "e domosdoshme", 0.5 për alternativën "e rëndësishme" dhe vlerën 0 për alternativën "jo dhe aq e rëndësishme".


### 6.3 Vështirësia e përfitimit të huasë<sup>13</sup>

Kostoja e kredisë vijon të konsiderohet si elementi kryesor që vështirëson përfitimin e një huaje bankare, në mënyrë më të theksuar për ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme. Vlerësimi për këtë element ka rezultuar në rënie krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar. Në vijim të kostonë së kredisë, edhe kostoja e plotësimit të kërkesave të bankës vijon të konsiderohet një vështirësi e konsiderueshme për të tre grupet e

<sup>13</sup> Për të vlerësuar vështirësinë e përfitimit të një huaje bankare, ndërmarrjeve iu është kërkuar të japin gjykimin e tyre për një sërë elementesh cilësore, sipas një sistemi vlerësimi me 5 shkallë, ku shkalla më e ulët e vështirësisë është 1 dhe shkalla më e lartë është 5. Për të marrë një vlerësim mesatar për secilin element cilësor, shkallët e vlerësimit nga 1 në 5 peshohen me peshat e përgjigjeve të dhëna nga ndërmarrjet.

ndërmarrjeve, ndjekur nga vlerësimi i kushteve për garantimin e kredisë dhe paqartësia e kërkesave të bankës apo procedurat burokratike. Gjithsesi, këto elemente kanë shënuar rënie për periudhën e vrojtuar.

**Grafik 6.6 Niveli i vështirësisë së përfitimit të një huaje**




Burimi: Banka e Shqipërisë.

#### 6.4 Planifikimi i huamarrjes


Lidhur me planifikimin për huamarrje në gjashtëmujorin e ardhshëm, bazuar në përgjigjet e ndërmarrjeve gjykohet se kërkesa për kredi jep sinjale të mira rigjallërimi. Rreth 39% e ndërmarrjeve të përgjigjura deklarojnë se “nuk ka asnjë mundësi” që të kërkojnë një kredi bankare gjatë periudhës së ardhshme, por në krahasim me vërtetimin e periudhës së mëparshme, kjo peshë ka rënë për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve. Ky ngushtim ka qenë më i dukshëm për ndërmarrjet e mëdha. Për më tepër, vihet re një rritje e peshës së ndërmarrjeve që pohojnë se “ka pak mundësi” të marrin një kredi në gjysmën e dytë të vitit 2020, si edhe e peshës së ndërmarrjeve të cilat shprehen se “ka shumë mundësi” që diçka e tillë të ndodhë në periudhën pasardhëse. Nga ana tjetër, të gjitha grupet e ndërmarrjeve, kanë shënuar një rënie për alternativën “është e sigurt”, duke shprehur pasigurinë e situatës në planifikimin e huamarrjes. Vlera e indeksit të vlerësimit të planifikimit të huamarrjes për gjashtëmujorin e ardhshëm<sup>14</sup> ka rezultuar 0.43 për totalin e ndërmarrjeve, më e lartë në krahasim me periudhën paraardhëse.

**Grafik 6.7 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas planifikimit të huamarrjes**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Grafik 6.8 Indeksi i planifikimit të huamarrjes**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

<sup>14</sup> Për të vlerësuar përgjigjet e ndërmarrjeve është ndërtuar indeksi mbi planifikimin e huamarrjes, llogaritur duke peshuar peshat e përgjigjeve të ndërmarrjeve ndaj totalit të përgjigjeve sipas një koeficienti, i cili rritet me rritjen e mundësisë së huamarrjes. Koeficienti për alternativën: “nuk ka asnjë mundësi” = 0.25; “ka pak mundësi” = 0.5; “ka shumë mundësi” = 0.75; “është e sigurt” = 1.